



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2018:044106

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05761666

P.nr.317/18

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA NË KAÇANIK, Departamenti I Pergjithshem, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri me bashkëpunëtorin profesional Ismajl Kuçi, në lëndën penale, ndaj të pandehurit Y.SH nga Rep. e Shqipërisë, me adresë banimi në Tiranë, për shkak të veprës penale, Falsifikimi I dokumenteve nga neni 398 par.1 të KPRK-se, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.1552-10/18 të datës 08.08.2018 jashtë shqyrtimit gjyqësor, më datë 31.05.2024 mori këtë

A K T V E N D I M

Ndaj të pandehurit, Y.SH nga Rep. e Shqipërisë, me adresë banimi në ..., rr. "Unaza e Re", I lindur me dt.... nga I ati M. dhe e ëma S., e gjinisë Rexhepi, shqiptar, shtetas I Rep. së Shqipërisë, me profesion mekanik, I gjendjes së dobët ekonomike, me nr. të letërnjoftimit:...,

HUDHET Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj me nr. PP.nr.1552-10/18 e datës 08.08.2018, për shkak të veprës penale, Falsifikimi I dokumenteve nga neni 398 par.1 të KPRK-se, për shkak se është shkaktuar ndalesa absolute për ndjekje penale.

Shpenzimet e procedurës bijnë në ngarkim të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, ka ngrit aktakuzën PP.nr.1552-10/18 të datës 08.08.2018 kundër të pandehurit Y.SH nga Rep. e Shqipërisë, me adresë banimi në ..., për shkak të veprës penale, Falsifikimi I dokumenteve nga neni 398 par.1 të KPRK-së.

Gjykata konstatoi se vepra penale, Falsifikimi I dokumenteve nga neni 398 par.1 të KPRK-së, është kryer me dt.30.05.2018.

Sipas nenit 106 par.1 nënpar.1.5 të KPK-së, (04/L-082), për veprën penale, Falsifikimi I dokumenteve nga neni 398 par.1 të KPRK-së, është paraparë afati i parashkrimit prej 3 vite, ndërkaq sipas nenit 107 par.8 të KPK-së, është paraparë se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së parashkrimit.

Prandaj në bazë të kësaj, gjykata konstaton se për veprën penale, Falsifikimi I dokumenteve nga neni 398 par.1 të KPRK-së, me dt.30.05.2024, ka arritur afati i parashkrimit.

Meqë nga dita e kryerjes së veprës penale dhe ditës së marrjes së këtij aktvendimi kanë kaluar më tepër se gjashtë vite, gjykata ka gjetur se ekzistojnë shkaqet për hudhjen e aktakuzës sepse është shkaktuar parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Nga sa u tha u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P.nr.317/18 datë 31.05.2024

Bashkpunëtori profesional

Ismajl Kuçi

Gjyqtarja,

Zajrete Muhaxheri

Këshilla juridike: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.